

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

- 
- |   |         |
|---|---------|
| 1. Pagja botnore e kristjanizmi në mesazhin e Hendersonit | Fq. 537 |
| 2. Mâ e madhja plagë në njerzim: tuberkulozi              | „ 542   |
| 3. Lahuta e Malcís ( <i>Lufta e Balkanit 1912-1913</i> )  | „ 550   |
| 4. Kremtet perkujtimtare të M. Luterit                    | „ 559   |
| 5. Shkrimtarët e sotshem                                  | „ 563   |
| 6. Botime të reja Historike                               | „ 567   |
| 7. Vlera e imperativit kategorik të Kantit                | „ 571   |
| 8. Urtí e burrní nder banorë të Cemít                     | „ 579   |
| 9. Quo Vadis...? — Pj. II. — 2                            | „ 9-16  |

## — T U J U R U E —

qi **pajtimtarët t'onë** gjithsa janë, mrendë e jashtë Shqypnije, t'a presin me gzim e t'a gzojn me çka u don zëmra Motmotin e ri, u lutena gjith njatyne qi, strukë nen mlojen krizi, nuk e kan krye detyren e vet ndaj administraten t'onë, qi mos të na e vonojn mâ giatë pajtimin, tuj mendue damin qi na shkaktojn e pengimet qi na qesin në vijimin e nji vepres qi ka per qellim të mirën, të maren, perparimin e ktij popullit t'onë bujâr. Njiheri u lajmojm të gjithve se **D i f t o j s i n** e ksajë vjetë kan per t'a mârrë bashkë me dy Numrat me të cillët, si patem lajmue, kemi per t'i kujtue, e mendja na thotë per së shpejti, gjithnjata e vetem njata të cillët mrenda ktij moji të Dhetorit të kën pague mostjeter pajtimin e vjetës qi po myllet.





## Pagja botnore e kristjanizmi në mesazhin e Henderson-it.

Der dje, kasnecat e popujvet paten bertitë: duem bukë e punë, duem tagre e lirí, duem të shtrihemi e të fitojm edhe mâ, me sá sod, nji goje qesin e thonë: *duem pagjë*.

Rreziku i madh i shkatrrimit, qi i rrin botës mbi krye, ásht bâ nji kaher i të gjithvet.

Konferencat e padame per të ndreqë perpjekjet politike, per të vû në hullí ekonomí e financë, per t'u dhânë punë të papunvet e per të rregullue çashtjen e çarmatimit, të gjitha kto, me perfundime të pa knaqshme, njohtojn kjartë se rrezikun e kemi në derë. E sá mâ i aferm rreziku aq mâ e largët pagja.

Qe nji provë e gjallë se shpnesa e plotë në kulturen utilitare u trand; ndergjegja e nierit dán e lodhun prej pezullimit në të cillin e qiti shfrytsimi i fuqivet të natyrës, e si me dashtë me kthye në veti, sheh nevojen të marrë drejtime tjera per me pshtue vleren reale të jetës nierzore.

Me at masë qi nieri bjerrë shpnesen nder të mira e perftime të kulturës materjale, me at masë qi kerkon të kapet per nji themel të qindrueshem, fillon t' a ndiejë nevojen e religionit.

Kahë, kryetari i konferencës së çarmatimit thotë se „*popujt mos t' a kerkojn sigurín e jetës në zbatimin e forcës, por n' auktoritetin moral të nji systemit të perbashkët*“ qet poshtë dynamizmin shtetnuer me të gjitha masët e mndyrët e zbatimit, kerkon qi jeta e pagja të pshteten n' auktoritetin moral e në solidaritet, qi shqyp don me thanë: besë e burní, me Zotin per qanderr.

